



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Bujqësisë, me qëllim të rritjes së transparencës dhe duke u bazuar në Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Prishtinës hap Thirrje për gjashtë përfaqësues të shoqërisë civile si pjesëmarrës i procesit të vlerësimit të garantëve dhe subvencioneve për vitin 2026 .

Për të përzgjedhur përfaqësuesin e shoqërisë civile në cilësinë e anëtarit të Komisionit, me qëllim të vlerësimit të procesit për dhënie të garantëve dhe subvencioneve, ftohen OSHC-të aktive në lëmin e bujqësisë në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre. Ftesa është e hapur për të gjitha OSHC-të nga lëmia e bujqësisë të regjistruara dhe rrjetet e OSHC-ve në Kosovë, pavarësisht anëtarësimit në Platformën CiviKos.

KRITERET PËR ORGANIZATAT QË NOMINOJNË KANDIDATËT

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të që:

- Janë të regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asocimit në Kosovë;
- Ekzistojnë të paktën gjatë 3 viteve të fundit dhe punojnë në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe medias.

Për t'u nominuar nga një OShC, 6 (gjashtë) kandidatët (prej tyre 2 rezervë) duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Të jetë i/e angazhuar në sektorin e shoqërisë civile në Kosovë;
- Të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- Të ketë kualifikim në fushën e bujqësisë, nivelet (BA/MSK);
- Të ketë përvojë pune në shoqëri civile, minimumi 6 muaj;
- Mos të ketë qenë i angazhuar në 5 vitet e fundit në Drejtorinë e Bujqësisë në Komunën e Prishtinës dhe institucionet tjera relevante;
- **Angazhimi do të jetë në baza vullnetare, për punën e bërë nuk do të kompensohen;**

- Kandidatët e përzgjedhur do të jenë pjesë e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve;
- Kandidatët e përzgjedhur obligohen që nga momenti i emrimit nga Kryetari i Komunës të jenë aktiv gjatë gjithë procesit të përzgjedhjes së përfituesve;
- Mos pjesëmarrja në procesin e shqyrtimit administrativ të aplikacioneve dhe zhvillimin e vizitave në terren me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike pa ndonjë arsye nënkupton mos zbatim të përgjegjësi të marra.

Procedurat e nominimit

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë thirrje, ftohen që të nominojnë kandidatët e tyre përmes dorëzimit të dokumentacionit përkatës.

Nominimet duhet të dërgohen në formë elektronike në adresën zyrtare:
info@civikos.net, të administruar nga **Platforma CiviKos**.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Organizatat nominuese duhet të dorëzojnë:

- Një përshkrim të shkurtër të portofolios dhe përvojës së organizatës në fushën përkatëse;
- CV-në e personit të nominuar;
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës.

Procesi i përzgjedhjes

- Në rast se numri i kandidatëve që i plotësojnë kriteret tejkalon numrin e vendeve të parashikuara, do të zhvillohet një **proces votimi**.
- Procesi i votimit do të administrohet nga Sekretariati i Platformës CiviKos.
- Nominimet do të shqyrtohen nga një komision i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të CiviKos dhe të **Prishtina**.
- Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen zyrtarisht përmes email-it.

Nominimi mbetet i hapur nga data 24.02.2026 deri me datën 02.03.2026